



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2021

VENDIM

Nr. 156, datë 14.04.2021

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Alma Ahmeti, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Nenet 198/2, 190/2, 298/2, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal” (Dosje penale është e ndarë nga dosja penale me të pandehur {...}, {...}, etj).

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen gjyqësore me Kërkuese: “{...}, “{...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim të gjyqtarës Lindita Sinanaj”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; Person i tretë: Shoqëria {...}”, përmbarues {...}etj; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 333/a/2, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR